



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

## KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

*Me nje operator ekonomik*

**KOMUNA E ISTOGUT-Njësija e Prokurimit, të cilën e përfaqëson menaxherja z-ja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;**

**dhe**

**"LEDI MED", SHPK Komuna e Prishtinës, me NRB 810199613 të cilën e përfaqëson Drejtori z. Arben Alushaj (në vazhdim "Kryersi i shërbimeve", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:**

**"MIRËMBAJTJA E RENTGEN APARATIT NE QKMF NE ISTOG" LOT 1**

Nr. I prokurimit	633-19-3202-2-2-1 - Lot 1
Nr. I brendshëm	633 / 019 / 018-R / 2-2-1

**Neni 1 Lënda**

### **1.1 "MIRËMBAJTJA E RENTGEN APARATIT NE QKMF NE ISTOG" LOT 1**

**Lënda e kontratës kornizë është të krijojë kushtet duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit per kryerjen e shërbimeve si ne vijim:**

### **1.2 "MIRËMBAJTJA E RENTGEN APARATIT NE QKMF NE ISTOG" LOT 1**

1.3 Përdorimi i kësajë kontrate Publike Kornizë obligon vetem Autoritetin Kontraktues ne Istog.

1.4 kjo kontratë do te implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje kur Autoriteti Kontraktues deshiron të kryeje shërbime perkatëse.

1.5 Kryerstit te shërbimeve nuk do ti lejohet modifikimi – ndryshimi i çmimit per njësi.

1.6 Kjo kontrate Kornizë Publike do te ketë validitet (kohëzgjatje) 24. muaj, dhe është efektive nga data e nënshkrimit te njëjtës.

1.7 Kontrata hynë në fuqi me datë: **Gusht 2019** dhe perfundon me datë: **Gusht 2021**

## **Neni 2 Kushtet e dërgesës:**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **2** ditë, nga dita e dhenjes së urdheresës nga Autoriteti Kontraktues, ndërsa afati i fundit kohor i përfundimit të kësajë kontrate është muaj Gusht **2021**

2.2 Vendi i dorëzimit të shërbimeve do të jenë **QENDRA E MJEKSISË FAMILJARE NE ISTOG** – t adekuate të Autoritetit Kontraktues qendra urbane dhe rrugët tjera në teritorin e Komunës së Istogut.

## **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë të paraqitura në Ofertën Financijare, Lista e çmimit të paraqitur nga ofruesi i shërbimeve, datë: **06.06.2019** dhe njeherit pjesë përbërëse e kësajë kontrate.

3.2 Vlera e Parashikuar e kontratës për periudhën **24 muajore** është **9,000,00 €** dhe me shkronja: **Nëntëmijëeuro**

3.3 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: (**Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon +- 30% e vlerës së kontratës**) po që se për këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues. Ndërsa që se urdherblerjet kalojnë sasine totale të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%), pa marrë parasysh datën origjinale të nënshkrimit, e njëjta shkeputet automatikisht.

3.3 Kjo kontratë mund të shkeputet edhe me heret bazuar në Nenin 56.11 të Udhëzuesit Operativ të PP po që se e njëjta permbushet me çmim.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

## **Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kjo marrëveshje e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i kryesit të shërbimit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare;
- Plani për menaxhimin e kontratës

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 5 Komunikimet




- 5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.
- 5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.
- 5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.
- 5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe, në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:

"LEDI MED" Shpk

<b>Emri:</b>	Zize Bujupaj	<b>Emri:</b>	Arben Alushaj
<b>Pozita:</b>	Zyrtar Përgjegjes i Prokurimit	<b>Pozita:</b>	D r e j t o r
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	22.08.2019	<b>Data:</b>	22.08.2019
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

### PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
	2.2	<i>Gjuha e përdorur do të jetë: gjuha Shqipe, Serbe</i>
Çmimi	3.1	<i>Çmimi për shërbimet: e mirëmbajtjes, riparimit, servisimit dhe ndërrimit të pjesëve, përfshin të gjitha shpenzimet e transportit si dhe shpenzimet e personelit</i>
Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve	6	<i>24 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës.</i>
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Operatori ekonomik e riparon (servison) pjesën ekzistuese brenda çmimit të ofruar për mirëmbajtje (servisim), ndërsa në rast se ndërrohet pjesa (montohet e re) ajo paguhet sipas çmimit për njësi sipas specifikimit teknik të pjesëve.</i></li> <li>• <i>OE obligohet të mbajë evidencë për kryerjen e shërbimit duke e nënshkruar nga të dyja palët.</i></li> <li>• <i>Të gjitha pjesët e ndërruara duhen të jenë të njëjta me pajisjet ekzistuese ose kompatibil me sistemin</i></li> </ul>
Siguria e ekzekutimit	14.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 25 muaj</i>
Parimet e përgjithshme të pagesave	16.	<i>Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas kryerjes së shërbimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se shërbimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë shërbimet të cilat ofrohen gjatë mirëmbajtjes së rregullt të liftave dy herë në muaj dhe në rast defekti Autoriteti Kontraktues do të kërkoj nga operatori ekonomik intervenim duke mos llogaritur çmimin shtesë për shërbime.</i></li> <li>• <i>Të gjitha pjesët e ndërruara duhen të jenë të njëjta me pajisjet ekzistuese ose kompatibile.</i></li> </ul>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 21.1.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë</i>